



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL
DREJTORIA JURIDIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Tiranë, më 28.1.2026

Njoftim për vende vakante në shërbimin civil në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural

Në zbatim të nenit 26, të ligjit 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të Kreut II dhe III, të Vendimit nr. 242, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, në zbatim të pikës 9, të Vendimit nr. 719, datë 31.10.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, i ndryshuar, të Urdhrit nr. 93, datë 12.6.2024, të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”,

Departamenti i Administratës Publike ka shpallur procedurat e lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë si dhe pranim në shërbimin civil:

- Për lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë 1 (një) pozicion Përgjegjës i Sektorit të Autorizimit të Pagesave IPARD për Masën 1, Masën 3, Masën 7 dhe Masën 9, në Drejtorinë e Autorizimit të Pagesave, në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural - klasa e pagës: III-2.

<https://rekrutimi.administrata.al/shpalljet/shfaq/7136>

- Për lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil 1 (një) pozicion i lirë Inspektor në Sektorin e Autorizimit të pagesave IPARD për Masën 1, Masën 3, Masën 7 dhe Masën 9, në Drejtorinë e Autorizimit të Pagesave, në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural - klasa e pagës IV-1.

<https://rekrutimi.administrata.al/shpalljet/shfaq/7137>

- Për lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë 1 (një) pozicion Përgjegjës i Sektorit të Identifikimit të Mashtrimit dhe Parregullsive, në Drejtorinë e Parandalimit të Mashtrimit, Parregullsive dhe Riskut, në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural - klasa e pagës III-2.

<https://rekrutimi.administrata.al/shpalljet/shfaq/7139>

Janë të ftuar të gjithë nëpunësit e interesuar, pjesë e shërbimit civil si dhe kandidatët për pranim në shërbimin civil të aplikojnë për pozicionin vakant të shpallur. Në lidhjet përkatëse, mund të gjeni informacionin e plotë për kriteret, dokumentacionin, mënyrën dhe afatin e dorëzimit, si dhe përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionin/et.

Për më shumë informacion ndiqni faqen zyrtare të Departamentit të Administratës Publike në lidhjen:

<https://rekrutimi.administrata.al/shpalljet>

AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL